

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 618 Prot.

Tiranë, më 14.09 2015

VENDIM Nr. 101, datë 1.09.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 42, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, të datës 1.09.2015, pasi shqyrtoi *Relacionin mbi përcaktimin e standarteve* të kryerjes dhe paraqitjes së Raportit të sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit zhvillimor/kërkimor shkencor, paraqitur nga ASHA,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Relacionin mbi përcaktimin e standarteve* të kryerjes dhe paraqitjes së Raportit të sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit zhvillimor/kërkimor shkencor, paraqitur nga ASHA, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

**Raport i sondazheve arkeologjike në kuadër të projekti zhvillimor/kërkimor shkencor
"Titulli i projektit" - Investitori;Shoqëria e Licencuar/individ i licencuar¹/ ASHA/
Institucioni kërkimor shkencor.**

Përmbledhje e lëndës



1.

Përshkrimi gjeografik i zonës ku do të zhvillohet projekti zhvillimor/kërkimor shkencor

2.

Të dhëna mbi projektin zhvillimor/kërkimor shkencor

3.

Zona e kryerjes së sondazheve arkeologjike

4.

Metodologjia e ndjekur për kryerjen e sondazheve arkeologjike

5.

Rezultati i sondazheve arkeologjike

6.

Paraqitje e përmbledhur e potencialit arkeologjik të zonës

7.

Rekomandime

8.

Bibliografi

¹ ASHA propozon: në rastet kur sondazhet arkeologjike në kuadër të projekteve zhvillimore, kryhen nga individ i licencuar, në përbërjen e grupit të jenë të paktën 2 arkeologë, për të cilët duhet të përcaktohen qartë detyrat specifike. Arkeologët pjesë e grupit për kryerjen e sondazheve arkeologjike, duhet të marrin përsipër kryerjen e të gjithë procesit të punës në terren si dhe dokumentimin, përpunimin e gjetjeve dhe përgatitjen e botimit. Raporti paraprak që paraqitet për miratim në KKA, si dhe raporti përfundimtar i vlefshëm për botim, duhet të firmoset nga të gjithë pjesëtarët e stafit që realizojnë procesin e sondazheve arkeologjike.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al

AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

1. Përshkrimi gjeografik i zonës ku do të zhvillohet projekti

- Përshkrimi gjeografik duhet të përfshijë një përmbledhje të shkurtër mbi të dhënat gjeografike dhe të karakteristikave gjeomorfologjike të zonës ku parashikohet të shtrihet projekti (Topografia, gjeologjia burimet natyrore, biodiversiteti etj.)
- Material fotografik i realizuar gjatë procesit të kryerjes së sondazheve arkeologjike në terren.
- Planvendosja e zonës ku zhvillohet projekti me koordinata sipas sistemit koordinativ shqiptar (*UTM34N*), ku të jetë evidentuar qartë njolla e projektit zhvillimor/shtrirja e projektit kërkimor shkencor (cad.dwg/arcmap.mxd).
- Kopje e Vendimit të Këshillit Shkencor të IA për projektin kërkimor shkencor
- Kopje e Vendimit të KKA për miratimin e projektit kërkimor shkencor/e kryerjes së sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit zhvillimor

2. Të dhëna mbi projektin zhvillimor/kërkimor shkencor

- Përshkrimi i projektit zhvillimor me të dhënat kryesore teknike të tij/ përshkrimi i projektit kërkimor-shkencor me të dhënat kryesore të pritshmërive shkencore;
- Gjendja aktuale e territorit, ku të specifikohet nëse është ndërhyrë në të apo jo, përse i takon projektit zhvillimor/nëse konstatohen ndërhyrje të pautorizuara (gërmime klandestine në rastin e projekteve këkimore shkencore) - (shoqëruar edhe me foto nga terreni).

3. Zona e kryerjes së sondazheve arkeologjike

Shpjegimi (tekst) dhe përcaktimi i qartë i zonës së kryerjes së sondazheve arkeologjike në planvendosjen e projektit zhvillimor / kërkimor shkencor.

AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

- a. Zona ku janë kryer sondazhet arkeologjike në planvendosjen e projektit shoqëruar me koordinatat përkatëse (cad.dwg/arcmap.mxd).
- b. Procesi duhet të shoqërohet me mbajtjen e skedave të gërmimit arkeologjik, të cilat pasqyrohen dhe gjatë hartimit të raportit. Format i origjinal, një kopje e tyre, si dhe formati elektronik (FileMaker) dorëzohet pranë ASHA në rastin e projekteve zhvillimore; për projektet kërkimor shkencorë dorëzohet një kopje e listës së njësive stratigrafike dhe një kopje e listës së gjetjeve (edhe në format elektronik). Modeli i skedave që do të përdoren është i miratuar me Vendimin Nr. 2, datë 30.01.2009 të KKA.
- c. Përshkrimi i zonës ku janë kryer sondazhet arkeologjike duhet të shoqërohet me paraqitjen grafike të procesit të kryer, ku përfshihen:
 - Sondazhet e gërmuar të dimensionuar, pasqyruar në planvendosje me koordinatat përkatëse (cad.dwg/arcmap.mxd).
 - Foto nga kuadratët e gërmuar (ku të jetë qartësisht e dukshme tabela me të dhëna sa i takon: emërtimit të projektit, data, vendi, autoriteti/institucioni/shoqëria e licencuar)
 - Foto gjatë kryerjes së sondazheve arkeologjike të stafit të arkeologëve (drejtuesi teknik dhe arkeologët e terrenit).

4. Metodologjia e ndjekur për kryerjen e sondazheve arkeologjike

- a. Metoda e ndjekur për realizimin e sondazheve arkeologjike, që nga fillimi i procesit e deri në fund
- b. Mjetet e punës të përdorura për dokumentimin e procesit
- c. Përbërja e grupit të punës (arkeologë) për kryerjen e këtij i përfshirë në këtij procesi arkeologjik dhe detyrat e tyre
- d. Dimensionet e sondazheve arkeologjike (thellësia e sondazheve përcaktohet nga arritja e tabanit natyror)
- e. Metodologjia shoqërohet me paraqitje teknike:
 - i. Foto ilustruese;
 - ii. Pikat e marra me GPS në terren të pasqyruara në hartë (cad.dwg/arcmap.mxd), ku përfshihen koordinatat e sondazheve të gërmuar, gjetjeve të caktuara, monumenteve apo siteve të njohura në afërsi të vendndodhjes së projektit, etj.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS

AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

5. Rezultati i sondazheve arkeologjike

- a. Përfundimet e nxjerra nga realizimi i sondazheve arkeologjike
 - i. interpretimi i gjetjeve (materiali përbërës i tyre, gjendjen që ato ruhen, datimi, listimi i gjetjeve, dokumentacioni i mbajtur në terren dhe hedhja e tyre në bazën e të dhënave formati - *FileMaker*, proceset konservuese restauruese, fondet ku do të depozitohen).
 - ii. Paraqitja e gjetjeve me foto
- b. Në rastet kur nuk janë evidentuar gjetje arkeologjike duhet argumentuar mungesa e tyre.

6. Paraqitje e përmblendhur e potencialit arkeologjik të zonës

- a. Paraqitja e potencialit arkeologjik të zonës, përfshin në mënyrë të përmblendhur:
 - i. përshkrimin e monumenteve të kulturës të shpallura (sipas listave të IMK),
 - ii. siteve arkeologjike, gjetjet arkeologjike rastësore të botuara deri më tani,
 - iii. toponimia e zonës përreth e cila është tregues i dëshmisë së vendbanimeve ose rrënojave të periudhave të ndryshme.

7. Rekomandime

Bazuar në rezultatin e sondazheve arkeologjike dhe mbi konsultimin e bibliografisë së specializuar për zonën, ekipi që kryen këto procese, rekomandon si më poshtë:

- a. Mbikëqyrje arkeologjike gjatë zbatimit të punimeve (në rastin e projekteve zhvillimore)
- b. Kalim në gjurmim arkeologjik shpëtimi kur sondazhet rezultojnë me material arkeologjik ose struktura.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al

AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

- c. Propozim për shpalljen e strukturave të zbuluara në mbrojtje paraprake/monument kulture dhe krijimin e zonës së mundshme të mbrojtur rreth tij.
- d. Propozimin për mënyren e ruajtjes në një gjendje sa më të mirë të objekteve të restauruara.

8. Bibliografi

- a. Përfshin titujt e materiale shkencore të fushave të ndryshme të cilat janë përdorur për studimin e zonës dhe materialit arkeologjik.

9. Të tjera

- a. Sondazhet arkeologjike nuk mund të kryhen pa prezencën e drejtuesit teknik të shoqërisë së licencuar/individit të licencuar /ASHA/drejtues i projektit kërkimor shkencor të përcaktuar në vendimmarrjen e KKA.
- b. Sondazhet arkeologjike duhet të shoqërohen me procesverbalin e fillimit dhe përfundimit të tyre i hartuar nga mbikëqyrësi i përcaktuar në vendimmarrjen e KKA.
- c. Fotot në të gjitha rastet kur përdoren gjatë raportit shoqërohen me diçitura.
- d. Raporti dorëzohet në dy kopje (me ngjyra) të nënshkruara nga specialistë arkeologë dhe përgjegjës sektori ASHA/drejtuesi teknik i shoqërisë së licencuar, edhe në format elektronik
- e. PowerPoint i raportit të përmendur më sipër, hartat dhe Fotot (në DVD-Rom).
- f. Relacion i shkurtuar për mbledhjen e KKA i nënshkruar, edhe në format elektronik

Përgatiti:

**Stafi i projektit (Individ i licencuar / Shoqëri e licencuar/ Individ i licencuar/ASHA)
Drejtuesi i projektit kërkimor shkencor)**